

# LUAN QAFEZEZI

BIBLIOTEKA

8JH-1  
016

poemë

# I INTERNUARI

354-1  
Q16

LUAN QAFËZEZI

# I INTERNUARI

(POEMË)

SHËNIMTËKA I SHTËPËR  
BOTIMEVE

34919  
30332

N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHËRI»

**Redaktor: Dalan Shapullo**

**Korektore letrare: Neka Turkeshi**

**Piktor: Pandi Mele**

**Redaktor teknik: Adem Lita**

---

Tirazhi 1500 kopje   Formati 70 X 100/32   Stash: 2204-55

---

Shtyp. N.I.Sh. Shtypshkronjave «MIHAL DURI», Tiranë, 1964

### Këng' e parë

I vogëlth ish qyteti bregdetar,  
Qytet a fshat nuk dije, jo, ç't'i thoje,  
Po qiell më t'bukur kot që të kërkoje  
            Mbi trollin amëtar!

E breg më t'artë syri s'të shikonte:  
Plot mandarina, qitro, portokaj,  
Ku dhe janari ndriste posi maji,  
            Kur lulja dhen' mbulonte!

Ja, ktu nj'agim Iliri djellin pa,  
E këtu Gjergji ziliqaren hënë,  
Këtu një dit' të shtrenjtën fjalëz: nënë!  
            Loreta belbt' e tha!

### Këng' e dytë

Me lodërza çdo ditë ju kalonte:  
Jasërthi, kut e cingël, apo çetën,  
Po neve ende s'dimë pér Loretën  
            Qysh Gjergji ëndërronte!

E ndofta as edhe Ilir Topinë  
Ndokush në jetë kurr s'do ta ket' parë,  
Po Gjergji dhe Iliri të pandarë  
            E shkuan vogjelinë.

E qysh në atë moshëz fëminie,  
Me ta Loret' e bukur gjithmon' qe,  
Ajo i dha fuqi çdo dit' të re  
E gas asaj miqsie!

Kështu tre vogëlushët në agime  
E prisin shoqi shoqin pa durim,  
Rreth botës fantazinë fluturim  
E nisnin në shtegtime!

Dorinjtë qen' shkopinjëz prej kallami,  
E lundrat o anijet: copka letër!  
Po djemve dhe në Jon tej bregut tjetër  
U vajti nami!

Kështu këta luftarë të hazdisur  
Vërshonin mbi asqerin mizëri,  
E flamuj ata ngrinin për liri  
Mbi malet e thepisur!

E detit, të sprovuar si detarë,  
Lundronin përmbi valë e mbi tallas!  
Sa her' buçiste bregu par e pas,  
Kur delnin fitimtarë!

E kur që nga betejat plot lavdi  
Këthenin përmbi kuajt e harbuar,  
Te shkëmbi vash' e tyr' e përmalluar  
U derdhej drejt në gji!

Aher' si lum' rrëfimet irridhnin vetë,  
Tregonin qysh mbi turqit nisën sulmin  
E gazi dalngadalë mbrinte kulmin  
Piratët kur i mbysnin krejt në det!

### Këng' e tretë.

Ju ende, miq të dashur, s'kini hyrë  
Në muret e kështjellit legjendar:  
Posht tija shtrihet deti dallgëfryrë,  
O hera her' i qetë si pasqyrë:  
Si qielli në behar!

Mbi male ky kështjell nuk është ngritur,  
Po pranëz, ku rreh bregun val' e zjarrtë,  
Veç gjë, asgjë nuk ka pér t'u çuditur,  
Në se as dhe tri pash' nga faq' e ndritur  
E detit s'ësht m'i lartë!

Po ç'hyn këtu në punë lartësia,  
Kur trojet s'ka tufan që ja lëkund?  
Kala të tillë kurrë dashuria  
Që kurse zuri fillin gjithësia  
Nuk ngriti asgjékund!

Si lule brënda sajë lulëzonte  
Loreta si perritë në rrëfim,  
Dy shokve dashurinë ua shtonte  
E gazi, që prej saja gjith mburonte,  
Nuk kishte perëndim!

Prej cmirit kundërshtarët të tërbuar  
Me çeta ju vërsulshin me furi,  
Po Gjergji që çdo luftë e kish fituar  
Me shpatë përmes ziarrit të pashuar  
I zembrapste përsëri!

Me të edhe Iliri i pandarë  
Po s'shquhej aqë shumë në luftim,  
Si Gjergjin bregu i detit s'kishte parë,  
Sa turq në pellgje gjaku kishte larë  
Pa shok' ai kryetrim!

E, ja, këtë virtyt kalorësie  
Loreta shum' e shum' ja kish zili,  
Kur kthehej me një ndjenj' mirnjohtësie  
A gazi, apo malli — dashurie  
I futej prap' në gji.

### Këng' e katërt.

Kështu filloi, pastaj ngadalë u rrit  
Në bangëzat e shkollës miqësia,  
Ashtu si rriten lulet në saksia  
Kur vasha i ujit!

Pa shkuan, vite shkuan pà u ndjerë,  
Me ta dhe vogjëlia e pafaj,  
Plot èndrra i rinisë i pari maj  
Shkëlqeu një pranverë!

Me flokxit pëndë korbi, syulli  
Loreta gjithëmonë zbulukurohej  
E shtat' i saj si kresht' që më lart çohej:  
Gjasonte si selvi!

Po Gjergji e Iliri si më parë  
Për të me mall të zjarrtë bisedonin,  
E prap' me zemrën flakë dëshëronin  
T'u mbetej e pandarë!

— Besomë, Ilir! Të t'hem ç'ësht' e vërteta:  
Atë as vetë s'di se sa e dua...  
Vecse pa të besoj se edhe jeta  
E zbet' do t'ish për mua!

— Si motr' e dua, Gjergj, dhe shpesh për të  
Një mall të zjarrtë ndjej në kraharuar,  
E, ja, kjo flak', që kurrë s'ka të shuar  
Më fort më djeg gjithnjë!

— Oh, ja, tek vjen! Jo shoqja kund s'iу gjet!  
Nga bukuria lule jargavani,  
E nga urtia: ndrit, si yll karvani  
Kur udhën çan ndër netë!

— E çelur, Gjergj, si qielli ynë i dlrë  
Krijes' më t'paqt' kjo tokë kurrë s'pa,  
E pafajninë kush zili s'ja ka  
Ng'ata q'ë njojin mirë.

Kështu dy shokët ëmbël bisedojnë,  
Ajo afron, po ende ata flasin,  
E përsëri me shoqet tek e mësin  
Më lart atë e çojnë!

### Këng' e pestë.

Po Gjergj Vasinë rritur si dre mali  
Ajo e donte aq sa shumë herë  
Me buz' në gaz, në ëndërr, shënd e verë  
E rrakte fort nga malli.

Po q'ishte, vall', ky mall që s'kishte emër  
Mos: miqësi a ndofta tjetër gjë?  
Po ky mister shigjetë ish pér të,  
Q'i ngulej thellë në zemër.

Veç dhe Ilirin t'afërt, të pandarë  
Ajo e kish ashtu posa dikur.  
Kur mbi shkëmbinj prej lecke një flamur  
Valvisnin tok më parë!

Po tash e Gjergjit pamja, burrëria,  
Aq shum' e shum' asaja i pëlqente  
Sa dhe në jetë: sjellja, urtësia,  
Kur gjegje kujt i kthente.

Jo, jo, tani të vegjël s'ishin më  
Njëri detar e trim posa zgalemi,  
Tjetri mësonjs' e i dijshëm, sa polemi  
Në goj' e kish gjithnjë.

E kto virtyte t'rralla njerëzie  
Me dashuri të dyve tek ua çmonte,  
Një ndjenj' pér Gjergjin zemrën ja pushtonte  
    Me forc magjie!

— Oh çfar' çudie — thosh, e pér hata  
Nga turpi duart vinte pérmbi sy —  
Jo, jo, kjo s'ngjet, un vllezër që të dy  
    I kam ata!

E prap' e prap' me mendje dot s'e kapte  
Se gjer ku shkonte vau i miqësisë,  
**E** ku pastaja kopsht' i dashurisë  
    Të artët shtigje hapte.

### Këng' e gjashtë

Ngjyrat ylberi derth mbi det e dhé  
E bregu artë mbarë kuqëlon,  
Në mes të valve djelli zë noton  
    Si nus' e re.

E breg' i gjërë mbushet më çdo krah,  
Erëra lulesh enden an e kënd,  
Të tilla mbrëmje rrall' në ndonjë vënd  
    Njeriu pa!

Të ulur pleqt' kundrojnë plot dëshirë  
Kët' perëndim të mrekullt ngjyrë gjak,  
N'sa rrez' e fundit majat tek pérflak,  
    Ju thotë: Lamtumirë!

Po atyre prap' çunakët tek vështrojnë  
U vjen në mendje koha që s'ka kthim,  
Aher' me zjarr e ah e mallëngjim:  
Rinin' kujtojnë!

Dhe Mihal Teni hallet dalngadalë  
Me Ndrek Topinë e plakun Lek Vasi  
Me dert i qan, ashtu si di ai,  
Me t'urtat fjalë!

Se që të vegjël tok pérherë qenë,  
E në të ri sërishmi të pandarë,  
Nëpër stuhi mbi det si peshkatarë,  
Shoshoqit shpesh iu gjenë:

Tani me èndje heshtur i shikojnë  
Tre bijt' e tyre bregut tek shëtisin,  
Ndërsa të tjerët varkat pregatisin  
Mbi det t'lundrojnë!

\* \* \*

Tre pleqtë miq, q'i lidhi shumëjeta  
Ne le t'i lëm' një ças në qetësi,  
E tek Iliri, Gjergji e Loreta  
Le t'kthejm' përsri.

Tek shkëmb' i tyre t'etur kanë shkuar,  
Ashtu si bënин viteve njëherë,  
Kur e rinis' e bukura pranverë  
Edhe nuk ish afruar!

— A tē kujtohen, Gjergj, ato agime  
E ky kështjell që kurr' s'do ta harroj?  
Këtu vogjlia èmbël ne na shkoj  
Nëpër lodrime!

Un' si Donika ishja mbretëreshë,  
Kurse Iliri trim e bir ushtari,  
Ti si Skënderi: kryeluftëtari  
Mbret mbi Arbreshë!

— E si dy syt' tē dy ne ty tē donim,  
Kur hasmi derdhej, derdheshim në ças,  
Për ty, mbretnesh', dhe jetën ne me gas  
Shpesh her' dhuronim!

— Për tē, o Gjergj, dhe ujrat larg i çamë  
Piratët, jo, gjékund nuk na shpëtuan,  
E nëpër Jon kudo që bashkë shkuam  
Gjithmonë emër lamë!

Kështu rrëfejnë e qeshin që tē tre,  
Kohëz e shkuar fort i mallëngjen,  
Po ja që Gjergjët prapë i pëlqen  
T'i kthej atje!

— Dëgjo, Donik, dëgjo! Tē bje ndër mënd  
Me Kastriotin, ti kur u martove?  
E tok me njerzit gur' e drur' gëzove,  
Në dheun tënd?

**E Dukagjin', Topij', e Arjanitë**  
Ty me kanisqe t'erdhën gjithë gas  
**E nga të shtënët bregu or' e ças**  
**Buçiti atë ditë!**

Ajo e çelur qesh, e, një nga një  
Të tre n'kujtime tresin dhe një herë,  
**Po e vogjlisë e bardhëza pranverë**  
**Nuk duket më! ^**

### **Këng' e shtatë.**

— E qet' e kryeult' si nus' e re  
M'e bukur se sa vetë Afërdita,  
Dhe djellit për një ças i erret drita,  
Kur drejt ajo e sheh.

E t'mekur mbeten njerzit që e njohin,  
Ajo me ëmbëlsi i ngjatjeton,  
E, ja, dhe pleqt që kurr s'e kan' zakon,  
Ndalojnë që ta shohin!

Nga t'dheshmit më e ëmbla nimfë deti.  
Si konxhja gjin' e artë kur zbulon:  
E kush hiret e saja s'i lakmon?  
I gjith qyteti!

Po pem' e pjekur lëng kur çon në gojë  
Kopshtari më në degëz nuk e lë,  
Ashtu i bardhi fat edhe atë  
**Kushdi ku do ta çojë!**

Një tjetër Gjergj, aher', ka për të hyrë  
Midis e miqësin' do na përcajë,  
E lotët aj Loretës do t'ja thajë  
Mbi t'hijshmezën fytyrë;

Ndaj jotja në se do q'ajo të mbesë  
Ashtu si ti në zemër ke dëshirë  
Shpejt dora me guxim i duhet shtrirë  
Për t'bardhëzën fejesë.

— Po vall', Ilir, sikur të mos pranojë  
E ftesën me përbuzje të ma kthejë?  
Aherë, oh, çdo lidhje do mbarojë  
E plaga sado kohë që të shkojë  
Ballsam nuk do të gjejë!

E veç kësaj sërish nuk jam i qetë,  
Sense ajo që zemrën ma mundon,  
Gjith' ndjenja ësht' e konxhe që kërkon  
Si foshnjatë në jetë.

Kujdes të math e mirkuptim gjithmorë.  
E si fëmi ka et për ledhatime,  
Po ti, q'e njeh aq mir' natyrën time,  
Kuption dhe ndarjen tonë.

— Gabohe, Gjergj, ajo që n'vogjëli  
Virtyt e vlera fort gjithmon' t'i çmoi,  
E si aher' sërish dhe në të ri  
Dëshirë ka e mall të pakufi  
Në krah të të qëndrojë!

Pra, s'ësht ashtu por fort e përmalluar  
Prej kohe pret t'ja shtrish të shtrenjtin krah,  
Dhe këtë èndje shpesh ja kam diktuar,  
Besoj nga gazi ka pér t'flutuar  
Pér ty, o vlla!

### Këng' e tetë.

Jo, Gjergj Vasisë buka s'i pat shije  
E pér të fjetur sonte s'fjet' ay,  
Fytyr' e kthjelltë e vashës pa një hie  
Si perëndesh a zanë bukurie  
E gjallë i mbet ndër sy!

E hera her' dyshimesh i trishtuar  
Një brengë fort në zemër e godiste,  
Ndërsa matanë e qet' dhe e gëzuar  
Loret' e bukur, nus' e adhuruar  
Me mall e priste!

\* \* \*

Agimi ra e dritëza e artë  
Nga hapësira dheun e mbuloi,  
Qielli mavi shkëlqeu posa kartë,  
Ndërsa që thell' ngadalëz val' e zjarrtë  
Diku pak kryet çoi!

Po Gjergji priti gjer tre litar' kali  
Djelli u ngjit e bregu n'ar u la,  
Përfundthi det e sipër majë mali,  
Të tillë pamje ku natyra fali?  
Ku njériu pa?!

E n'atë pamje t'rrall' të bukurisë  
Me èmbëlsi bilbilat po këndonin.  
Ndërsa ndën qiellin mbret të kaltërsisë  
Si lajmëtare t'gazit — dashurisë,  
Pulbardhat fluturonin!

Po Gjergj Vasia tash sa kish arrirë  
Tek Mihal Teni, n't'ultëzën shtëpi,  
Loret' e bukur doli plot dëshirë,  
Gjergjefin la e trimin zemërdlirë  
E rrroku fort në gji!

Me buz' në gaz ahore plaku tha:  
— Kur vjen ti, Gjergj, shtëpia më gjëzon,  
Po, vall', Iliri, ç'pati që t'u nda?  
Edhe atë Loreta si vëlla  
E quan gjithëmonë!

Pastaj dy pleqt në paqë e qetësi  
I lanë ata e kopshtit dolën tok,  
Posi aher' në t'ëmblën vogjëli,  
Kur që të tre me gaz e dashuri  
Lodronin shok me shok!

E ulur pran' Loreta e shikon,  
Po Gjergj Vasisë goja krejt iu pre,  
Ajo e pyet e dot nuk e kupton  
Pse atij fjala sot po i mungon,  
Pse syt i mban përdhe?

— Përse, o Gjergj, o trimi im i çmuar  
Në syt' e tu sot paqë nukë gjej?  
— Më ndje, Loret', në shkela pa më ftuar,  
Po dashurin' nga zëmr' e adhuruar  
Kam ardh' të ta rrëmbej!

Si për çudi aher dhe vala mehu,  
Në deg bilbili këngën e pushoi  
E vjollc' e mitur strukur buzë dheu  
Si lulez djelli trupin drejt e ktheu  
                  E ëmbëlth i vështroi.

E aty pran' nga gazi edhe bliri  
Si flutra t'bardha lule mbi ta reshi,  
Ndërsa që larg i ndezur nga dëshiri,  
Er' trëndelinash miqëve zefiri,  
                  Iu pru në shënj' peshqeshi:

E nga ky hir qiellor, që dhen' mbulonte,  
Një lot kristal iu duk asaj ndër sy  
E, n'sa si n'ëndërr gazit fluturonte,  
Në kraht' e tij e lumtur taşh pushonte:  
                  Një trup qen' bër' të dy!

### Këng' e nëntë.

Joni buçiti e bregu fort gjëmoi,  
Tallaze valësh çoi Adriatiku,  
Nga Roma prap' si n't'lashtat kohë armiku  
                  Atdhen shkretoi.

E këmbë kryq ulkonja na u shtrua  
Me kuislingët bij të tradhëtisë  
E Roma fliste: — Orë e Shqipërisë  
                  Për jetë u shua!

Po që nga larg Tetori hodhi dritë,  
Qytet e fshat në këmb i ftoi Liria —  
Si shqipe malesh trimave Partia  
    Iu priu një ditë.

E stina ndrroi, fytyrë ndrroi dhe moti,  
Çekan e drap e laps mënjanë u lanë,  
E ng'ai ças: atdheut anembanë  
    Erdh er' baroti!

### Këng' e dhjetë.

Tani më rrall shoshoqin e takonin  
E atë mall e shtonin dit't e ra,  
Veç ata dy sërish nuk e kuptionin:  
Qysh ato orë aq shpejtz fluturonin?  
    Minuta qen' për ta!

— O Gjergji im, më ndje, po pa ty pranë  
Nuk di as un' pse ora më ngjan mot!  
Kurse me ty edhe në tramundanë  
Pengesë a vojtje t'ëmbëlza më janë,  
    Si kup' e mjaltit plot!

— Ashtu dhe un' përherëz lumturinë  
E ndjej, Loret', kur pranëz të kam ty,  
Se gjithë ëndrrat, lodrat, vogjëlinë  
Apo rinjinë, gazin, dashurinë,  
    I shoh tek ata sy!

LIBRARI I KULTURËS  
GJENIOSH PEP

3495 30332

— Veç, Gjergj i dashur, shpesh nuk jam e qetë,  
Që prindët tanë gjë nuk din' për na,  
Andaj mendoj më mirë do të jetë  
Këtë fole, që ne po ngre him vetë,  
                                 Ta njohin dhe ata!

E si të duan tok le ta caktojnë  
Të ëmblën dit' kur shpizën do ta lë,  
Sa fort, o Gjergj, sa fort do të gëzojnë.  
Bashkimin ton' me qef do ta bekojnë  
                                 E më s'do na ndaj gjë.

E ëmbla dit', Loretë, ësht' larguar  
Sot dashurinë Atdheut le t'ja falim,  
Flakët e luftës qiellin kan' mbuluar,  
Shqipja e jon' me plag' në kraharuar  
                                 Në male fton t'i dalim.

E për ata që majave po ngasin  
Yjet e par' ti vetë i qindise,  
A s'i ndjen pushkët thellë si buçasin?  
Ato dhe ty, Loretë, të thërrasin:  
                                 Ndaj yje prap' iu nise!

### Këng' e njëmbëdhjetë

Të mugtit bje e bregun dalngadalë  
Një napë e zezë thellë e mbulon,  
Me uturimë zjen e marra valë,  
Ndërsa i vetëm Gjergji paska dalë  
                                 E filli po shtegton!

Pa yrysh merr n      q   t  iu kaloj    
Te shteg i hapt  : e vetcja shpres' p  r t  :  
Po hapin, jo, nuk mundka lart ta   oj  ,  
Plag  z e ftoht' fuqiz  n ja shkurtoi  
P  rgjith  nj  !

E ng'ato plagë marrë krah më krah  
Shqiponj' e detit më nuk fluturoi,  
Po uj' i njelmët kurrë nukë pa  
Një shqipe tjetër thyer kofsh e krah  
Q'aq shum' qëndroi!

## Kënga e dymbëdhjetë.

Një shok nga burgu erdhi i menduar  
— Loretë, Gjergji sot nga ne u nda —  
Ajo dëgjoi e ngriu e pezmatuar,  
Ai më fort nga dhimbja i burrnuar  
            Një kart' i dha!

«Ky dhe i shtrenjt', q'e deshët ju dhe unë,  
Qe shesh i zjarrtë luftrash për liri,  
Këtu, Loretë, ëndrat fillin zunë,  
Këtu, Ilir, përparrë shpesh i vumë  
            Armiqtë un' dhe ti!

Po vojt' e gjak më kot nuk do humbasin  
Shkëndi e ndezur flakë lajmëron,  
Ja krismat prap' vazhdojnë të buçasin,  
Ato në dhe armikun do ta kllasin:  
            Sot bota mbar' gjëmon!

E, ja, tani mësoni nga kjo letër,  
Si shum' të tjërë vendin po e lë,  
N'agim të ri do jem tej bregut tjetër,  
Në internim, o miqt' e mi të vjetër,  
            Më çojn' përgjithënje!

Ndaj dhe një her' të dyve lamtumirë  
Ilir, vëlla, Loretën kij kujdes,  
Asgjë nga ju s'më ndau sa qesh i lirë  
E prap' me ju kudo në hapësirë  
            Do jem gjersa të vdes».

E me atë plag' që thellë e kishte ndjerë  
Shkoi e u ndal atje tek ai skaj,  
Përbri kalas' ku ngrihej shkëmb i prerë,  
Atje ku shpesh me mall e zjarr pérherë  
                E priste Gjergj' i saj!

— O Gjergji im nga dhimbja pikëlluar  
Loreta jote ty po të kërkon,  
Po shkëmbi hesht e val' e turbulluar  
Sado q'e lus, o trimi im i çmuar,  
                Asgjë nuk më tregon!

Më fol', o det', mos valët kund e panë  
Atë që dallgësh shpesh u gjet mbi ty,  
Më fol', më fol', në ç'hekura e kanë  
Apo mos vdekja Gjergjit m'i rri pranë  
                E un s'e shoh me sy?

Po qielli nxin e deti i tërbuar  
Me uturimë bregun rreh ngado,  
Tufan' i marrë rritet pa pushuar,  
Po prap' shqiponiat ciellit jan' lëshuar  
                Asgjë s'i ep ato!

### Këng' e trembëdhjetë

Si hëna, zonj' e qiellit, kur errsohej,  
Ashtu ajo shkëlaente n'atë breg,  
E malli, që në zëmra hapte shteg  
                Të rinjve peshë u çuhej.

Gazmorë print' e tyre nga çdo anë  
Parreshtur tek i ati e kërkonin  
E lajmësve dhurata u premtionin  
Për vashëzën si zanë,

Po kush pranë kështjellit aty pas  
Folen' e dashurisë mund ta ngrinte?  
Kush vendin Gjergj Vasisë mund t'ja zinte  
N'at zemër në tallas?

Po i ati, gjithë halle, burrë plak,  
Që s'dinte se çfar' brenge kish e bija  
Një dhëndër sipas èndjeve të tija  
Ja zgjodhi për merak,

— Yt at', Loretëz, moj, më çoj për gas,  
E fjalën e pëlqimit pret nga ti  
N'e dac, o bij', që sot nëpër shtëpi  
Hareja do t'buçasë!

— Jo, nënë, mua koha nuk më shkoj,  
E gjersa luft' e zezë do të zjejë,  
I lutem un tim eti të më ndjejë:  
Askund të mos premtojë!

S'e s'dihet, nënë moj, nëpër trazirë  
Njeriu që do më epni mund të tresë  
E pse ahere çupa ju t'u mbesë:  
Për jet' me fat të nxirë?

Pra, thuam', nënëz-o, a kam gabim? —  
E nëna gjithë hall e papushuar  
Të shoqit dalngadal' e shtruar shtruar  
Ja ktheu atë mendim!

## Këng' e katërmëbëdhjetë

— Sa kohë, Ilir, u bën' që s'e kam parë? —  
Me dhimsuri e zjarr e pyet ajo. —  
— Një muaj plot q'ai na është ndarë,  
Veç lotët ty edhe s'të janë tharë,  
Po lotë ai s'do!

— E di, vëlla, po zemra e brengosur  
Në hidhërimë lejë nuk kërkon,  
E helm' i fort', që thell' më ka plagosur  
Më lë pa gjum' e natën e pasosur  
Me mua tok e shkon.

Po dhe në gjum', pasëndrrash plot trazime  
Dëshir' e zjarrtë prapë ndërsy ma sjell,  
Pa më përtrihet koha plot gëzime,  
Kur të tre bashkë ditët me argtime  
I shkonim në kështjellë.

Ahere zgjohem, vlla, po për çudi  
Gëzim i rremë tret, e ja, në ças  
Stuhi e marrë shkrep më me fuqi  
E dhimbje e zezë dallgët përsëri  
Më egër m'i përplas!

E natën pyes ahere me të mirë:  
— O natë, moj, më thuaj, mos e di,  
Kur Gjergji im tej detesh në zinxhirë,  
Do të shpëtojë e prapë krahëlirë  
Do kthej' në bregn' e tij?

Po nata hesht e heshtja më mundon,  
Aher' e vetme shtratin shpejt e lë  
E nga dritarja detin që kundron  
Në pafundi ky syri që loton  
Kërkon atë!

Mendushëm djali thot' me dhimsuri:  
— E di, Loret', çfar' plage ti ke marrë,  
Po mos harro ç'detyr' të la ai  
«Kësaj beteje — lufte pér liri  
T'i mbetesh e pandarë!»

Pra, jo me lot' e ahe dëshpërimi,  
Po nga stuhi e zjarrit të paprerë  
Pérmbi atdhe do shkrepri prap agimi,  
Aher' ai, si n'tbardhat dit' gëzimi,  
Do t'kthehet pér ngaherë.

E prap të dy përmallshëm e kujtojnë,  
Atje ku vala derdhet me furi,  
Dhe ja njëzësh shoshoqit i premtojnë  
Se gjer në fund stuhis do t'i qëndrojnë,  
Si trimi Gjergj Vasi.

### Këng' e pesëmbëdhjetë

E lotët reshën. Shqipet s'derdhin lotë,  
Po përbëmajat sulen me vërtik,  
E që andej rrufe mbi çdo armik  
Lëshohen nëpër shqotë.

«Këtu, Loretë, nder s'ke asnje ças!»  
Kështu me vehte vasha kuvendon  
E padurimthi mbrëmja sa afron  
Gjerdanin ngjesh me gas.

E mauzerin fort shtérngon në duar,  
Atë mauzer që moteve dikur,  
Në dor' të t'et, Bregdetit shkëmb' e gur  
Mbi turqit pat' gjëmuar

E tash ajo mes shokësh shënd' e verë,  
Përtrin lavdin e grave arbërore,  
Posi Despina; Tringa malësore:  
Në ball qëndron pérherë

E nga Butrinti gjer në Llogora  
Kopshtij' e lundra shkretë ngado janë,  
N'sa Bregdeti krismash anëmbanë  
Gjëmon papra.

— O Gjergji im, kur flakë merr beteja,  
E vdekje zeza fushës bën kërdi,  
Kujtimi yt pa pra më jep fuqi  
Për sulme t'reja.

E kur i thyer hasmi me sveti,  
Mes rrjedhash gjaku çthuret në tufan,  
Si pér çudi, sërish, o Gjergj më ngjan  
Sikur gëzon dhe ti.

Ahere pran', vegimthi, shoh lirinë,  
E Atëdhen fatlum' e buzagas,  
E shkëmbin ton' q'krah hapur or' e ças  
Po pret t'i kthehesh tinë! —

Po Gjergji larg, e gjë për të më s'dinte  
Edhe Iliri ende në qytet  
Që, posa Gjergji, shokve nëpër net'  
Mbi hasmin rrept' iu printe!

Kështu n'furtunë, zvarrë jav' e muaj  
Kaluan varg e gjaku nënët drodhi,  
Gjersa Partia trojesh tëj e hodhi  
Një dit' vandaln' e huaj.

### Këng' e gjashtëmbëdhjetë

Lufta mbaroi e qelli farfuriti,  
Loret' e bukur yje më s'qëndis  
E as Ilirin netve nëpër tis  
S'e pret njësiti.

E më në kampe klithma nukë ndjehen,  
Po sa miljona qen' ata q'u tretën?  
Kurse të pakt skelet këta që mbetën  
N'atdhe po kthehen.

E ja, sado që gjuhë e doke ndrrojnë  
Shqiptarë, e rusë, e grekë, apo bullgarë,  
E malazez, polakë, apo maxharë  
Shoshoqin përqafojnë.

Kështu, një dit' shtëpisë i erdhën pranë  
E nën' e nuse dolën e i pritën,  
Po miqtë tanë thellë u tronditën  
Kur Gjergj Vasin' s'e panë!

Aher' me radh' Loreta gjith' i pyeti:  
— Më thoni, miq, kush Gjergjin, vallë e pa? —  
Po gjithsekush një fjal' asaj i tha:  
Në krematorë mbeti!

Veç një q'e njihte — Prit! — i tha me hall —  
Gjer afër fundit tok të dy qëndruam,  
Pastaj esesët gjetkë atë e quan  
Por ndofta është i gjallë,

Se, me sa di, atje s'u dogj njeri,  
Andaj besoj shëndoshë do të jetë  
E ndonjë dit' përmallshëm këtu vetë  
Do t'kthehet prapë ai!

## Këngë e shtatëmbëdhjetë

Dikur sa do me shkoll' Ilir Topia  
Për krahje edhe punë kurrë s'gjeti,  
Mbi krahë barrë prindërve u mbeti,  
Në ditët e këqia.

Po koħa skllave ligjesh shekullorë  
Si vendi i ċliruar ndroi ftyrë,  
I celur, ndriti Bregu, si pasqyrë  
Mes tingujve gazmorë.

E Iliri me Loretën n'at'agim,  
Si motit tē pandarë prap' shpejtuan,  
Me gas midis rinis' tē dy vrapanan  
N'betejat pér ndërtim.

...Po vajza n'ata sulme prap' kujtonte,  
Qysh Gjergji me urti i pati thënë  
Pér diellin që, në t'ardhmen vëndit tënë  
Çdo skaj do t'ja ndriçonte.

## Këngë e tetëmbëdhjetë

Dyzetepesa iku dalëngadalë  
Dhe moti tjetër treti e u çduk,  
Po Gjergj Vasia prapë nuk u duk,  
As çojti fjalë!

E më për të nuk fliste asnjeri,  
Përveç Ilirit, shokut të pandarë,  
Edhe Loretës, vashëzës së tij,  
Që gjithë brengë, mall e dashuri  
E priste si më parë!

\* \* \*

Mot edhe stinë shpesh fytyrën ndrruan  
E maj i tretë çeli plot freski,  
Aq herë lulet dheun e mbuluan,  
Po përsëri për të asgjë s'mësuan  
Dy miqt' e tij!

— Ilir, Ilir, çfardo që t'i ket' ngjarë,  
Un do ta pres, vëlla! Un do ta pres!  
Sepse ai qe ëndrra ime e parë,  
Prej tija zemra kurr s'më ka të ndarë  
Gjersa të vdes!

— As mua shpresat, jo, nuk më kan' lënë,  
Se nga ata q'u kthyen përsëri,  
Asnjë gjer sot, Loretë, nuk ka thënë  
Që ta ket' par' të djegur a të rënë  
Me syt' e tij!

— Ndaj kot e kan' gjithsa që më kërkojnë,  
Stoli e jashtme s'vlen as dhe një grosh,  
Ata si duket ende s'e kuptojnë,  
Se, kurm' i bukur q'aq e dëshërojnë  
Pa zemrën është bosh.

Veçse, Ilir, im at' për t'më fejuar  
Kohët e fundit fort po më shtrëngon,  
Vëlla, as unë s'di si kam shpëtuar  
Po dhe im më që fort më pat ndihmuar  
Tani nuk më ndihmon!

### Këng' e nëntëmbëdhjetë

Sa fate me urti i prapsi vetë,  
Sa trima një nga një i ktheu pas,  
Çdo prishje një fitore qe në jetë.  
Çdo kthim një rreze shprese gjithë gas.

E mendja fillon larg t'i shtegëtojë:  
«Do kthehet, a s'do kthehet, vallë, ai?»  
Pa shpres' po i pëlqen që të shpresojë:  
Ndër krahë t'i pështetet përsëri.

Kështu në ëndërrime nanuritet  
E mendja prap' i mbetet po atie:  
Në vatër drit' e llambës përpëlitet,  
Dy pleq qëndrojnë heshtur sy përdhe!

Po pse ajo nuk do që të martohet?  
Pse fatet një nga një po i kthen pas?  
Përlotur nën' e shkretë thell' mendohet,  
I ndezur gjëmon plaku gjith' maras:

— Pra, thuam', thuam', grua ku ësht' parë  
Ta pyesin prindët çupën: do a s'do? —  
E zbehtë mbushet nëna më të qarë,  
Të shoqit çfar' t'i thotë s'di ajo!..

Dhe heshtja thell' konakun e përpika  
Gjer plaku prapë grindet me furi;  
E struktur nënëshkreta s'pipëtika,  
Jo, paq' e gas më s'ka në ktë shtëpi.

\* \* \*

Një lajmës dje trokiti prap' në derë:  
«Një mjek dorën e vajzës ju kërkon.  
Të tillë fate vijnë rrallëherë,  
Fort rrall' të tillë fat njeriu takon!

Të zes më nukë janë flokt' e tij  
E ndofta është më se pesëdhjetë,  
Po ç'vlen përpara tija një i ri?  
Martesa tjetër gjë kërkon në jetë!»

Shkoi miku, po në vatër burr e grua  
Bisedën me urti e pleqërojnë:  
— Po, vall' sikur sérish të thotë: «s'dua!» —  
Nxin nëna — xhindet plakun e mbulojnë.

— Shko ti e fol me të edhe një herë! —  
E heshtur ajo ngrihet leht' e lehtë:  
—... Sérish foleja jote shënd e verë  
Ta ngrehësh bijëz-o po të thërret! —

Dhe, ëmbël, me të urtë nën' e shkretë  
I thotë, e ç'nuk i thotë, vallë, ajo?  
Nxin vajza posi quell i zën' nga retë  
E prapë fjalëprerë gjegjet: jo!

— Pse, bijë, lumturinë e lë jashtë,  
Në derë të babajtë, s'ke më nder,  
Dëgjomë, oh, dëgjom': njëzet' e gjashtë  
I mbushe, bijëz-o, këtë pranverë!

Pc lulet hieshinë gjithë e kanë  
Në muajt më të bukur prill e maj,  
Të nxehtit dalngadalëz i përthanë  
E vjeshta një pas një i merr pastaj.

Dhe e trishtët kryqin bën e thot' e shkreta:  
— Ti mendjen mbushja sot, moj Shënmëri,  
Që gas, një ditë gas të shoh' nga jetë:  
Fëmijt' e saj, o Zonj, t'i rrrok në gji! —

Pastaj e zbehtë, e zbehtë ajo largohet  
Po tan' përgjigje e vajzës e tërbon;  
I zymtë mbi atë ai lëshohet  
E rëndë, aqë rëndë e qëllon,

Sa gjaku vragë lë mbi dyshemenë,  
Veç vajza gjith' e qetë nuk nxjerr zë,  
Fytyra e djaloshit përtej denë,  
E ëmbël prap' i çfaqet si gjithnjë!

Po plaku turfullon: «Kjo pun' u sos!  
Të prita, po dhe pritja ka kufi,  
Jo ti, po un' për ty këtu vendos  
E fjalën dot s'ma kthen asnë njeri...»

## Këng' e njëzetë

E vetme erdh, e tretur, e menduar  
Dhe djelli sot i ngjan sikur u zbeh,  
Ai dëgjon e hesht i pikëlluar  
Ajo tregon e brengën nuk ja fsheh.

— Mbaroi! — i thot' — çdo gja vëlla, mbaroi,  
Im at' gëzimin mbrëm' ma ka varrosur,  
Tani dhe botën ndryshe e shikoj:  
Sado fuqi e shpresa s'më jan' sosur.

Dhe ja një flak', si flakëz e qiriut  
Më tret, vëlla, se ndofta rron ai  
E në se rron, qysh mundesh, vall' njeriut  
Q'aq shum' e deshe krahët t'i kthesht ti? —

Ai i zymtë hesht duke dëgjuar  
E vogjëlia gjith' ndër ment i bje,  
Sa her' me të në lodra pat harbuar.  
Ç'gëzim për të gjithmonë ajo qe,

E, sado q'ishin shokë të pandarë  
Për të me Gjergjin fliste shpesh e shpesh,  
Ajo qe gazi, èndrr' e tyre e parë,  
Që malet fush' e kodrat i bën shesh.

E prap' nga mënt' s'i hiqet fëminia,  
As ai mall q'i lindi në vogli,  
Por ah, serbes — fitonjës zotëria  
Që do t'i ndaj — i gjall' ndër sy i rri! —

**Mendon t'i thot': — «Atë q'e deshëm shumë  
E pritëm fort, po duket larg mbaroi,  
Q'aher', Loretë, vitet rrodhën lumë,  
Po s'erdh ai e fjalë kurr' s'na çoi.**

**E meqë s'erdh pse duhet të pranojmë  
Të na veçojnë sot përgjithënë?  
A s'ësht' më mirë bashkë të jetojmë,  
Gjersa në jet' s'na ndau ne asnje gjë?»**

**Kështu mendon, po syve të trishtuar  
Një lot i murmë lehtas u pikon,  
Se vet' i dyt' një kuadr' i paharruar  
Aty përball i vrenjtur e shikon.**

**E ja, i ngjan sikur ajo e mjerë  
Vështrimin therës ngulur mbi të ka,  
Sikur me zjarr i shfryn si asnjeherë:  
— Si s'të vjen turp? unë ty të quaj vëlla!**

**E pranë saj dhe Gjergji i menduar  
I ngjan sikur tërthor i hedh një sy,  
Sikur i thot': — Si vlla të paç kujtuar  
E plot besim në duar ta lash ty!»**

**Aher nga vehtja ndot i erdh atij  
E si gjithnjë në orët plot tallas.  
N'at marramëndje rishmë gjet fuqi,  
Dhe ja asaj për t'dal nga ajo stuhi  
Iu gjend në ças.**

## Këng' e njëzetenjëtë

Me angushti një def po përpëlitet,  
E me trishtim po pritka një duvak,  
Po jasht' polemi pyet edhe çuditet,  
Qysht' atë vajz', që ndrit si rreze dritet  
Ja dhan' një burri plak?

E dasma zjen. Gëzushëm fort heqimi  
Me far' e fis e miq po ngre dolli,  
E po ashtu, i dehur nga gëzimi,  
Dhe Mihal Teni, gjersa zbardh agimi,  
Me miqt' e tija pi!

Dhe pijn' e pijn', të etur, të gëzuar,  
Në dy shtëpitë ahengu fort gjëmon  
Po n'dhom' të saj e lodhur, e vetmuar  
Nus' e pafat nga gjindja e veçuar  
Mbi një portret qëndron.

— O Gjergji i im, sa larg aq edhe pranë  
Loreta ty të pati dit' e net!  
Për ndarjen tonë pijnë ata matanë,  
Gëzim, o Gjergj, si duket sonte kanë:  
Me ta edhe im et!

Po ja agoi! Kështjelli u zbulua  
E val' e turbullt bregun tonë rreh!  
O, ti kështjell ç'kujtime sjell tek mua,  
Si Gjergjin tim, o vendthi im të dua:  
Ti gas gjithnjë më dhe!

**Aty një herth' un fronin tim e ngrita,  
Aty vogjliza émbël krejt më shkoi,  
Aty krahapur Gjergjin shpesh e prita,  
Aty sekond' o Breg më ngjau dita  
E kohës që kaloi. —**

Dhe t'ämën lut, ngadal' e me të qetë:  
— A mundem, nënë, mjekun ta takoj? —  
Pa ditur gjë, gazmore nën' e shkretë,  
Tërthoraz dhëndrit shënj' i bëri vetë  
Në kthin' asaj ja çoi!

— Më ndjeni, mik, e lus të më kuptoni,  
Në punën time lërmëni të qetë  
E aq më keq në qoft' se ju shpresoni  
Nga zemra skllave rrahje të dëgjoni  
Por jo, kjo kurrë s'ngjet!

Pra, me sa duket, juve historinë  
Ende s'ma dini mir' në hollësi,  
Po un si syt' e desha Gjergj Vasinë  
E mënt e mijë prap' atje më rrinë  
Dhe zemra tek ai.

E një portret i nxjerr ajo e qetë:  
— Ja ky ësht' Gjergji, mjek, q'e pres me mall. —  
Cliruar ankthit plaku, thot' i zbetë:  
— Po ky djalosh ç'prej vjetësh, moj Loretë  
Nuk është më i gjallë!

— Në ësht' a s'është, mirë nuk e di,  
Po n'zemrën time Gjergjin gjall' e gjen,  
E, gjith ç'i fala, mik, në vogjeli,  
Apo më von', në t'bukurzën rini,  
Askush dot s'ja rrëmben!

Ndaj me të mir' ju lus të hiqni dorë  
Dhe për këtë të bindni dhe tim et,  
Që miq sërish të mbetemi ne prorë,  
E ndonj' skandal a tmerr në këtë orë  
Mos ngjasë në qytet.

— Si flet kështu? Oh ç'njoll' tyt eti i vë!  
Sa tmerr, për të Bregdeti ta marr vesh!  
Pret një që vdiq e kurrë s'do kthehet më?  
Por ti, që sot ndërmote, përgjithnjë,  
E imja do të jesh!

E krahët hap ai për ta pushtuar,  
Po: «Ndal!» ajo e prerë i thërret,  
E përball tij si shkëmb duke qëndruar  
Si pul të lagur mikun e moçuar  
Prej dhomës e qet.

Dhe syt' e saj portretin drejt shikojnë:  
— O Gjergji im, ti hiç mos u trishto;  
Ahengu zjen, po nusja që shpresojnë,  
Nesër n'agim, kur krushqit ta kërkojnë,  
Fort larg do t'jet' ajo.

## Këng' e njëzetedytë

I jati rob zakonesh shekullore,  
I fyer e kërkojti prak më prak,  
Hakmarrja, kjo përbindëshe mizore,  
Në ças ja shoi çdo ndjenjë prindërore  
E hov i dha pér gjak.

Dhe gjaku i pafajë atë ditë  
Shtëpin' e Mihal Tenit do kish larë,  
Sikur Ajo që vendit i jep dritë,  
Ajo që zap i bën edhe stuhitë  
Në gji mos ta kish marrë.

...Dhe shtruar sekretarit t'Komitetit  
Gjith brengën vash' e shkretë ja tregoi,  
E i tha: «Do t'ish më mirë larg qytetit,  
Larg vendit tim të lindjes. Bregut detit,  
Diku n'Atdhe të shkoj!»

I prekur sekretari i ndëj prorë,  
E punën, duke parë me urti,  
Si at' edhe një herë i dha dorë.  
Q'e ardhmja, si në çastet më gazmorisë,  
T'i queshte përsëri.

## Këng' e njëzetetretë

Jo, si më par' Loreta s'shihej më,  
Midis rinis' gazmore të Bregdetit,  
Ndërsa legjenda thureshin qytejt  
Ngado pér të!

Pa lënë gjurm' — tregonin — u largua,  
E diku larg e vetme ditët tre'ti,  
Por kur u bind se Gjergji luftës mbeti,  
Me nj' tjeter u martua. —

Të tjerë shtonin: — djalë i ka lerë  
E plag' e sajë krejt tani u mbyll,  
Ai fëmi i bukur porsi yll  
Gëzim' i sjell pérherë! —

Po në kuvende grash me fantazi,  
Më llafazanet flisnin tërë zjarr,  
Sikur me sy aty ta kishin par':  
— Piu helmn' e zi!

E ng'ajo kup', kur gruan pa të shtrirë,  
Edhe i shoqi piu me qetësi,  
E botës bashk' një ore pér çudi,  
I thanë: Lamtumirë! —

Kurse të tjerët thoshnin: — Ajo rron  
Në vetëmi e Gjergjin gjithnjë pret,  
E sadoher' q'e sheh atë portret  
«Do t'kthehet!» prap' mendon.

Po në t'vertet' asnjera s'dinte gjë,  
Në ish a s'ish e ç'bënte vall' tani,  
Veç, si gjithnjë legjendat përsëri  
Nuk mehën kurr' pér të.

## Këng' e njëzetekatërt

Kur nga Raishtagu kryq' i thyer ra,  
Në t'Perëndimit dhe të Gjermanisë,  
Si robve mbar' ashtu dhe Gjergj Vasisë  
Lirim iu dha!

E në atdhe të kthehej shpejt kërroi  
Nga nj'oficer i shtabit aleat,  
Po ky zabit i ndezur plot inat,  
Me ndot' edboi

I prekur djali drejt ndër sy e pa  
E jo, nga vendi s'llojti grimëz hapi,  
Po oficeri shpejt në gryk' e kapi  
E fort mbi ballë i ra!

Përgjakur Gjergjit bota rrëth iu drodh  
«Këtu — mendoi — goditet Shqipëria»,  
Aher' vetimë u lshua si stuhia  
E tej zabitn' e hodh!

Ja, një dit' Maj kështu atje qëlloi  
E gjyq' i tyre rrept' e me shpejti  
Dhe pesë vjet shqiponjës Gjergj Vasi  
Lirinë ja mohoi!

\* \* \*

Si shekuj, miq, kaluan ata vjet,  
Mbi ball' të djalit koha viza shkroi  
E nga trishtimi floku ngjyrë i ndrroi  
Si ndrron çdo gjë në jetë.

Dhe ja: të lir' e lanë përsëri,  
Po «Aleatët» zotër si ngaherë,  
E prap' esesët veshur oficerë  
I pa me syt' e tij!

Aher ngadal' kufirit i shkoi pranë  
Dhe errësirën priti me durim  
Pastaj në terr, i vetëm, plot guxim  
U hoth matanë!

«Dy Gjermani — dý bot'» ai mendoi,  
Andej skëterrë e burgje pa mbarim,  
Këndej: e re, çdo gjë në lulëzim,  
Si dita që agoi.

E n'ambasad' mes shokësh shpejt u gjet,  
Ku që të gjith' me gas e pritën fort,  
E, pas aq vjetsh, n'avjon, me pasaportë,  
U nis për n'dhe të vet!

\* \* \*

... E, ja në fund dhe tokë e Shqipërisë,  
Atdheu i dashur, vend i shtrenjt' për të,  
Djep' i trimnive, besës e lavdisë  
Ku, dimër-ver', prej gazit, ngrohtësisë.  
Pranvera qesh gjithnjë.

Avjoni zbret, e lot' atij i bijen,  
Po kush me urdhër lot' mbajti, vall?  
E ja, tani kujtimet i përtrihen  
E, ndërsa lot' sërish ndërsy i shihen,  
Fort dheun puth me mall:

— Posi të verbitit drita më qe shuar,  
Andaj, Atdhe, me lot më sheh ndërsy!  
Tiranë, moj, sa fort paske ndryshuar!  
Parti e shtrenjtë, o nën' e adhuruar.  
Yt' bir të falet ty!

### Këng' e njëzetepestë

Me një makin' plot gas për në Bregdet  
Sot Gjergj Vasia, miq, po udhëton,  
Atje me mall e presin prindt' e vet  
Dhe, si ata, e bukura Loretë,  
Që zemra s'ja harron!

E çan makina, çan me shpejtësi,  
Po në kujtime tretur ai ka,  
Përparrë svish kështjelli prap' i tri:  
Hiri del e fort me dashuri  
E rrrok atë si vlla!

Po ky vegim rrëmbimthi i mërgohet,  
Qyteth' i shtrenjt' shkëlqen në afërsi,  
Ja dhe kështjell' e tij se ku naltohet,  
Atje ku vala bregut i gëzohet  
E los me brogori.

Makina ndal e Gjergji pa ngurrim,  
Valixhen merr e zbret me shpejtësi  
E at' rrugic', si n'ditët që s'kan' kthim,  
E ngjit ai e prindve plot gëzim  
U vete në shtëpi.

Me angushti ngadal' mbi der' troket  
Po kush nga prindët, vall, do dalë aty?  
**Dera u hap — e, ja, një zonj' e qetë:**  
— Ç'urdhroni, bir? — me turtë atë e pyet,  
E émpl' e sheh ndër sy!

— Më ndjeni, zonj' — po plaku Lek Vasi  
A nuk banon këtu, te kjo ndërtësë? —  
Kështu i thotë e gruas me habi  
Posi shigjet' ja ngul dy sylt' e tij:  
Ata dy sy plot shpresë!

— Ne s'e arritëm, bir, po njerzit pranë  
Tregojn': — ky kopsht i vogëlth për zili  
E kjo shtëpizë e ngritur si kuti  
Të tijat janë!

**E me keqardhje zonja rishmë tha;**  
— Një djal' të vetëm kishin këta pleq,  
Por, ah, i shkreti, biro, mbaroi keq,  
Në dor' të hasmit ra!

Me plagë atë e kapën në betejë  
E n'internime lidhur larg e çuan  
Pas lufte, jo, me shokët që shpëtuan  
Nuk mundi më të kthejë

E gjithsa erdhën: — Vdiq! — të gjithë thanë  
E këtë koha, biro, e tregoi  
Kështu, ai, i vetëm larg mbaroi:  
Të shkretët pleq s'e panë!

— I mjeri djal'! Po vallë print' e tij,  
Ku jan' o nën'? — me ankth djaloshi pyet  
— Një ditë dimri, biro, në qytet  
                  Kur zbriti një hordhi.

Me egërsi, si shumë qytetarë,  
I kapi, ah, dhe ja te ky oborr,  
Dh'ata dy pleq, me kripin bardh si borë,  
                  I la të vrarë!

Kështu prej tyre më tanë s'jetojnë,  
Po për ata që qenë aq të mirë  
Fqinjët me dhimbje, mall edhe dëshirë  
                  Gjithnjë, o bir, tregojnë.

E ajo hesht, po djalit si rrufe  
I bje ky lajm' e lotë i pikojnë  
E at' valixhe duart ja lëshojnë  
                  Në ças përdhe!

— Më ndjeni, bir, për fjalët që dëgjuat.  
Po këta pleq ç'i kini, vallë, ju?  
E përse lot për ta ju ran' këtu  
                  E fort u pikëlluat?

— Oh, falmni zonj', por, ah, nga kjo qytezë  
Ja, kjo familje q'erdha të kërkoj  
Dikur tim eti jetën i shpëtoi  
                  Nga vdekj' e zezë!

E, meqë udha sot këtej më ra,  
U ndala pak' e desha t'i takoj,  
Po lajm' i zi fort zemrën ma helmoi  
Që më nuk jan' ata!

— U tretën, bir, veç von' nëpër qytet  
U muar vesh se djaln' e internuar  
Një vajzë e re me mall të patreguar  
E priti shumë vjet!

Sa kapedanë, biro, e kërkuan  
Sa lajmës-o, i shkuan shpesh në prak,  
Po me përdhun' parvjet me një mjek plak  
Prindt' e fejuan.

E kur në dasëm kënga ngrihej la  
Apo e vetme mbyllur në një kthinë,  
Duke kujuar trimin Gjergj Vasinë  
Aspak s'u dha.

E historin' e lidhjeve të saj  
Fill e për pe doktorit ja tregoi,  
E i tha hapt: «As vdekja s'do t'guxojë  
Prej tija të më ndajë!

E një portret, o bir, me qetësi,  
Përpara mjekut nxori n'atë ças,  
«Ky është Gjergji — i tha — q'e pres me gas  
Si i verbti dritn' e tij!

Andaj ju lus ju vet' të hiqni dorë,»  
Po kur e pa se mjeku nuk pranoi,  
Për t'i shpëtuar tmerrit q'e rrethoi  
U çduk që atë orë.

**E se ku** është, mirë nuk e di,  
**Po Gjergj** Vasinë prap' ajo e priti  
**Gjersa** një ditë pritja e drobiti  
    **E më s'i** mbet fuqi.

**Aher'** o bir! — siç thonë — u martua,  
**E një** fëmijë lindi mbas një vit,  
**Porse me shpirt e gjora** as një dit'  
    **Prej Gjergjit** s'u largua

**Dhe,** ai portret gjithnjë qëndron atje  
**E sado** mëmë, trimin Gjergj Vasinë  
**Posi** dikur, në ditët që më s'vinë  
    **Përmallshëm** prap' e sheh.

**Veç,** si ajo — shton zonja me urti —  
**Edhe** një shok i tij nga vogjëlia,  
**Ilir** i thon', shpreson se Gjergj Vasia  
    Do kthehet përsëri.

**Bile** ai nga t'afërmit e tjerë  
**I vetmi** ësht' që Gjergjin e kujton  
**E për** shtëpin, ashtu si ka zakon,  
    Kujdes tregon ngaherë!

— Më ndjeni zonj', se fort ju kam munduar!  
— Jo, biro, jo, un' falje ju kërkoj  
Që për kta pleq kaq shumë të nderuar  
Me hollësi më gjat' si kan' jetuar  
    Nuk dijta t'ju tregoj.

Kështu ngadal' me dhimb ajo vijon,  
Po Gjergj Vasia tinës lötët fshi  
E, ndërsa drejt shtëpin' dot s'e shikon,  
Edhe një herë atë e falnderon  
E shkon ai!

### Këng' e njëzetegjashtë

Nga humbj' e rënd, i heshtur, i menduar,  
Ai kalon në udhë vetmitar,  
Atje ku shpesh, nga gazi i rrëthuar,  
Me miqt' e tij dikur kishte lodruar  
Plot mall e zjarr!

— Eh, vendth' i im, pse hesht e nuk më thua  
Ku prehen, vall', të gjorët prindt e mij?  
Dëshir' e zjarrtë thell' në shpirt m' u zgjua,  
U erdha pran', por ah, ata që dua  
Nuk qënkan më tani!

I mjeri at', sa fort do më kesh pritur,  
E, nënëz, ti, sa shpesh do më kesh qarë  
Por ja, baba, un' sot sa kam arritur  
O nënëz, moj, tani porsa kám zbritur,  
Po ju s'kam pér t'ju parë!

E shkretë sot m'u duk shtëpia jonë  
E drejt me sy nuk munda ta shikoj,  
Po shpirti im atje ësht' gjithëmonë  
E po atje gjer n'ditën më të vonë  
Gjithnjë do të qëndroj.

E at kolibez shpesh ku lozja unë,  
Jo, në oborr, o nën', s'e gjeta më,  
Po kush e di ç'tallas me valë shumë  
A erë e marrë a ndofta ndonj' furtunë,  
Ma shëmbi përgjithnjë!

Kështu mendon e bregut shkon ngadalë,  
Kështjell e tij sërish po e thërret,  
Po, si dikur, mbi të përplasen valë,  
Ai i sheh e hapin nis ta ndalë  
E zemra sa s'i mbet!

— Tregom', kështjell' i ditve t' miturisë  
Ku ëndërrime neve thurëm plot,  
Ç'u bë Iliri, krah i Gjergj Vasisë  
E, vall' Loreta, lul' e dashurisë,  
Ku ësht? Ku është sot?

Ti hesht, kështjell, po unë tash të tjerë  
Shikoj aty në lodra tek vrapijnë,  
Të gjithë tok ashtu si ne njëherë,  
Veç tek i shoh rrëth teje shënd e verë  
Vogjlizën' më kujtojnë! —

E ajo prap' si n'orët më gazmore  
I çfaqet, krejt ashtu posa njëherë,  
Kur në vogjli e t'bardhat dit' rinore  
Pranë kështjellit zënë dora-dore  
Lodronin shënd e verë!

E n'mend i vjen aj ças, kur vala mehu.  
Kur dhe bilbili këngën e pushoi  
E kur dhe violca strukur buzë dheu  
Si lule djelli trupin drejt e ktheu  
E ëmbël i vështroi:

«O nus' e shtrenjtë e ëndrrav: të mia,  
Sa pran' e larg prej teje jam iani,  
Veç më beso: me mall porsi fëmia  
Të erdha, vashë e ëndrrave të mia,  
Veç larg sot qënke ti!

E kodrën ngjit. Shtëpia e Topisë  
Mes portokajsh e bliresh po e fton!  
Dera u cil... po ngrirë prej habisë,  
Iliri vetë, shok i miturisë,  
Dot syve s'u beson!

«Në s'jam përgjumsh a syri s'më gënjen  
Kjo do të ishte veç një mrékulli,»  
Kështu statuj — i ngrir', ay e vren  
Pastaj me ankth e droj dy fjalë i kthen:  
— Mos Gjergji, vall', je ti?

— Un Gjergji jam ashtu si tì po thua! —  
Por kësaj her' Topija gjegje s'dha,  
Veç si dikur rrëmbimthi u lëshua  
E m'atë mall, që kurr në shpirt s'iù shua  
Ndër kraht' e shokut ra!

E tē pushtuar fort ata qëndruan  
Si nē vogjli, kur losnin tērē zjarr,  
**Po**, kur u ndanë e ēmbël u shikuan,  
Syt' e Ilirit shpejtaż perënduan  
E kok' e tij u zvar.

— Vështrömë drejt, se gjith' e gjith sa ngjanë  
Fill e pér pe, vëlla, un mir' i di,  
Veç varret', jo, edhé s'di ku i kanë,  
Tēr' jetën tok, e tok një dite ranë  
Të shkretet prindt' e mi!

**Po**, sado dhimbje kam nga plag' e shuar,  
Gëzim, vëlla, nē zemër më buçit,  
Se pîk' e gjakut kot s'më paska shkuar  
Atdheu i im ngado paska ndryshuar  
E kjo më përtërit!

Që nga Tiran' e bukur, ku len drita,  
E gjer këtu, Ilir, te bregu ynë,  
Në çdo qytet a skaj ku ünë zbrita,  
Ndërtime pash', vëlla, e u çudita  
E lot' ma mbushën synë!

E te ky dhe nē ditët që do vinë  
Ka pér t'u gjetur, ndofta, ndonjë skaj,  
Ku jetën time, t'arthmen, qetësinë,  
Pa i prékur botës: gazin-lumturinë,  
Ta ngre dhe un' pastaj.

Po dhe asaj që èndrra ime qe.  
Lus që martesa gas t'i sjellë pérherë  
E fmijt' e saj të qeshur në Atdhe,  
Mes brohorish të rriten plot hare,  
Si lulet në pranverë.

— O Gjergj të dobitit thyhen në shtërgatë,  
Ndaj fatet tuaj lufta dot s'i ndrroi,  
E, as dhe udhët s'mundi t'ua veçoi,  
Kalvar' i gjatë.

Në ato dit' të zeza si skëterrë.  
Ti pér lirinë mallin e le pas,  
Ajo si ti gjerdanin q'atë ças  
E ngjeshi menjëherë

E në se shqota larg ty, larg të qiti,  
Në atë val' kur flakë ndizej dheu,  
Të zjarrtën ndjenjë kurrë nuk ja theu,  
As ja fashiti.

E mbas fitores n't'bardhëzin agim  
Kur gjith' besonin: Gjergji s'kthehet më!...  
Me ëmbëlsi, ajo, më thosh gjithnjë:  
Do kthehet Gjergji im.

E kur në fund i jati pér martesë  
Fjalën e dha e dasma mori horë,  
Ajo pér ty e qet' në atë orë  
Vendosi larg të tresë.

E midis shqesh shpejt fitoi lavdi,  
Atje ku nat' e dit' endin pëlhurë,  
Po dhe kur end nga mëndja s'e hoq' kurrë  
Të sajin Gjergj Vasi.

Dhe kurr' e kurrë shpresa nuk iu dergj,  
E as martuar ësht' as ka fëmi,  
Veç si gjithmonë ty me krenari  
Të pret, o Gjergj!

Aher gëzimi caqet i kalon.  
Dhe Gjergj Vasia rishmë krahëlirë  
Të bukrën èndër sheh të përtërirë:  
Kështjell' i tij e fton!

E krejt i ngjan n'at ças të paharruar  
Sikur çdo gjë për rrëth i brohoret.  
Sikur i thot': shpejto për ta gëzuar,  
Se padurim ty, nus' e adhuruar  
Prej kohsh të pret!

— Ilir, Ilir, po nisem me shpejti.  
Dëshir' e zjarrtë ndezi shpirtin tim!  
Kështjell i shtrenjtë pritëm përsëri,  
Shtëpiz atnore dasëm do kesh ti  
Në t'bardhëzin agim.

Dhe ja gazmor, rrëmbyshëm ai treti,  
Për tek Loreta, vashëza e tij,  
E atëbot' iu duk sikur qyteti,  
E me të bashk' gëzushëm edhe deti  
Shpértheu në brohori.